



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:072681

Datë: 04.11.2019

Numri i dokumentit: 00622703

P.nr.39/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. J. nga fshati S. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2619-10/18, të datës 25.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, të akuzuarit R. J. dhe mbrojtësit të tij Av.K. K. nga Prizreni i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 30.10.2019 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datën 04.11.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari R. J., nga i ati V. dhe e ëma Xh. J. e vajzërisë B., i lindur me 27.09.1976, në fshatin S. Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa dënuar për ndonjë veprë penale, mbrohet nga liria. me numër personal,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.01.2019, rreth orës 10:30 në fshatin S., Komuna e Suharekës, në shtëpinë e tij familjare, mban në posedim të paautorizuar armë, ashtu që me të pranuar informatën policia pasi shkon te shtëpia e të pandehurit, i njëjti ua dorëzon pistoletën e tipit “..” kal. 7.62 mm. me numër serik C-16....., prodhim “Z.” 1 (një) karikator të pistoletës kal. 7.62 mm dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) fishekë të kalibrit 7.62 mm të cilat i pandehuri i ka mbajtur në posedim pa leje të organit kompetent dhe në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-022 për Armët.

Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Pranohet marrveshja mbi pranimin e fajsis PP/II.nr.19-10/2019 e dt. 24.01.2019 e lidhur mes prokurorit të Shtetit - Prokurorisë Themelore në Prizren e nënshkruar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore dhe prokurori i çështjes në njërën anë dhe të akuzuarit R. J. dhe mbrojtësit av.K. K., në anën tjetër.

Gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 46, 73, 74, 75, 76, të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 500 euro, të cilin duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qese dënimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **prej 25 ditësh**, duke llogaritur për 20 € të filluar me një ditë burg, konform nenit 46 paragrafi 3 të KP-së, dhe

DËNIMI PLOTËSUES

Në kuptim të nenit 374 par.3, i konfiskohen pistoleta e tipit “.” kal. 7.62 mm. me numër serik C-....., prodhim “Z.”, 1 (një) karikator të pistoletës kal. 7.62 mm dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) fishekë të kalibrit 7.62 mm.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumë prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2619-10/18, të datës 25.01.2019, kundër të akuzuarit R. J. nga fshati S. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, aktakuzën të cilën gjatë seancës gjyqësore prej fillimit e gjer në mbarim e ka përfaqësuar PSH Beqë Shala, i cili në tërësi ka ngelë pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, në përputhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila i është bashkangjitur aktakuzës.

I akuzuari ka lidhur marrëveshjen për pranimin e fajësisë në prokurori me numër PP/II.nr.19-10/2019 të dt.24.01.2019 në prezencën e mbrojtësit Av.K. K., dhe në seancë qëndron në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

I akuzuari gjithashtu në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin të fajësisë ka deklaruar se ka qenë i vetëdijshëm, i informuar me benificionet dhe pasojat e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe se me vullnetin e lirë në prani të mbrojtjes e ka nënshkruar të njëjtën dhe ka heqë dorë nga një gjykim i rregullt, ku do të administroheshin provat, në shkëmbim të një dënimi më të butë.

Gjykata në seancën dëgjimore për pranimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë të mbajtur me dt.30.10.2019 dëgjoi palët ku PSH ngeli si në aktakuzë dhe kërkoi nga gjykata të aprovoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënimin e propozuar në marrëveshje të rekomanduar në pikën IV të marrëveshjes, pasi që marrëveshja është nënshkruar me vullnetin e palëve dhe është në përputhje me nenin 233 pika 18 e KPP-së.

I akuzuari gjithashtu kërkoi që gjykata të aprovon marrëveshjen dhe ti shqiptoj dënimin e rekomanduar në pikën IV të saj.

Gjykata e pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pasi që e njëjta është në përputhje edhe me provat materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës nga Prokuroria e Shtetit dhe se e njëjta nuk është në kundërshtim me paragrafin 18 të nenit 233 të KPP-së dhe ka shqiptuar dënimin e rekomanduar si në marrëveshje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP-së. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË P.nr.39/2019 të dt. 04.11.2019

**Bashk.Profesional
Feim Bytyqi**

**Gjyqtari
Qemal Suka**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.